



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 764 Akti

Nr. 767 Vendimi  
Tiranë, më 29.5.2024

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

|                       |           |
|-----------------------|-----------|
| <b>Etleda Çiftja</b>  | Kryesuese |
| <b>Lulzim Hamitaj</b> | Relator   |
| <b>Firdes Shuli</b>   | Anëtare   |

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Jonida Vrana, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier, në datën 28.9.2023, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Sofia Zhilla**, ish-inspektore pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b** i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;  
**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;  
**Ligji nr. 96/2016**, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;  
**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;  
**Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017**, i Gjykatës Kushtetuese.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, z. Lulzim Hamitaj, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe dokumentacionin e paraqitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe nga institucione të tjera, pasi analizoi çështjen në tërësi, bazuar në vlerësimin tërësor të procedurave, sipas pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016,

**V E R E N:**

**I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Znj. Sofia Zhilla është subjekt rivlerësimi, për shkak të funksionit të saj si ish-inspektore

pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese dhe të ligjit nr. 84/2016. Kësisoj, bazuar në pikën 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016). Znj. Sofia Zhilla, duke u konsideruar si subjekt rivlerësimi *ex officio*, u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, pasi u përzgjodh me shortin e hedhur, në datën 15.6.2021, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit” (në vijim Komisioni).

2. Referuar nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin ka filluar menjëherë me caktimin me short të trupit gjykues, me këtë përbërje: komisioner Lulzim Hamitaj, në cilësinë e relatorit; komisionere Etleda Çiftja dhe komisionere Firdes Shuli, anëtare.
3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016 dhe ish-Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (aktualisht Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016.
4. Trupit gjykues ka caktuar me mirëkuptim kryesuesen e trupit gjykues znj. Etleda Çiftja, si dhe u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga ana e secilit prej anëtarëve të këtij trupi gjykues.
5. Relatori i çështjes, në bazë të neneve 33 dhe 39 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e përpiluara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI) dhe Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK).
6. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti i rivlerësimit ka nisur procedurat e rivlerësimit, si vijon:
  - a. plotësimin dhe dërgimin e deklaratës së pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, pranë ILDKPKI-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
  - b. plotësimin dhe dërgimin e deklaratës për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, pranë AKSIK-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;
  - c. plotësimin dhe dërgimin e formularit të vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi, sipas nenit 41 të ligjit nr. 84/2016.
7. Nga informacioni i administruar ka rezultuar se lidhur me pozicionin e znj. Sofia Zhilla: (i) me vendimin e datës 24.11.1993 të KLD-së është emëruar ndihmës gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës; (ii) me vendimin e datës 30.3.1995, është transferuar, po si ndihmës gjyqtare, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë; (iii) me vendimin e datës 8.2.1996, të KLD-së, znj. Zhilla është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë; (iv) më pas, me vendimin e datës 20.3.1999, të KLD-së, znj. Zhilla është shkarkuar nga detyra e gjyqtares, me motivacionin “Për kryerjen e veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës”.

8. Referuar rrethanave të pasqyruara në vendimin e datës 18.2.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit, nuk rezulton që ky vendim të jetë kundërshtuar nga znj. Sofia Zhilla në gjykatë, e cila në vijim ka nisur ushtrimin e profesionit të avokatit pranë Dhomës së Avokatisë Tiranë e, më pas, është emëruar specialiste finance në sektorin e prokurimeve publike pranë Presidencës.
9. Ndërkohë, me vendimin e datës 18.3.2013, të KLD-së, znj. Zhilla është emëruar në detyrën e inspektore, me mandat 5-vjeçar pranë këtij institucioni dhe, më pas, me vendimin e datës 7.5.2018 i është zgjatur mandati i inspektorit deri në krijimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
10. Përgjatë hetimit administrativ, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka dërguar pranë Komisionit dokumentacion përkatës, ku ndër të tjera, edhe një kopje të vendimit nr. \*\*\* të këtij institucioni, datë 22.10.2019, me të cilin ka deklaruar mospasjen e statusit “Magjistrat” për znj. Sofia Zhilla. Ky vendim është ankimuar nga znj. Zhilla dhe Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. \*\*\*, datë 18.2.2020, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së paditëses Sofia Zhilla. Ndaj këtij vendimi është paraqitur rekurs pranë Gjykatës së Lartë, ku ende kjo çështje ndodhet në pritje për t’u shqyrtuar.
11. Gjithashtu, ka rezultuar se KLGJ-ja, me urdhrin nr. \*\*\*, datë 25.11.2019, e ka liruar znj. Sofia Zhilla nga detyra e inspektore së ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, pikërisht për mospasje të statusit të magjistratit dhe mosnënshtrimin e saj në një vlerësim të Shkollës së Magjistraturës, në cilësinë e inspektore, sipas dispozitave ligjore tranzitore.
12. Urdhri i shkarkimit nga detyra e inspektore në fjalë, si më sipër i cituar, ka rezultuar të jetë ankimuar nga znj. Zhilla dhe në vijim, Gjykata e Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 4.6.2020, ka pranuar kërkesën e paditëses (Zhilla), duke rrëzuar kështu urdhrin për lirim nga detyra – me pasojë ndërprerjen e marrëdhënies së punës me KLGJ-në. Ky vendim i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (nr. \*\*\*, datë 4.6.2020) është apeluar nga KLGJ-ja pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.
13. Më tej, Komisioni, me shkresën e datës 22.9.2023 i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë për të pasur më shumë informacione mbi ecurinë e kësaj çështjeje dhe kjo e fundit, me përgjigjen nr. \*\*\* prot., datë 26.9.2023, ka bërë me dije se çështja në fjalë ende është në pritje të një planifikimi për t’u shqyrtuar/gjykuar. Në këto kushte – sipas përgjigjes së KLGJ-së, për sa kohë vendimi nr. \*\*\*, datë 4.6.2020, nuk është zbatuar prej tyre pasi nuk është i formës së prerë apo i ekzekutueshëm – znj. Zilla aktualisht rezulton në mospasjen e kritereve plotësuese të ekzistencës së statusit të subjektit të rivlerësimit, për sa kohë nuk gëzon as statusin e magjistratit dhe as pozicionin e inspektore që mbulonte më herët.
14. Në vijim të procedurave administrative, pas hedhjes së shortit, subjekti i rivlerësimit është njoftuar nëpërmjet postës elektronike të deklaruar lidhur me çeljen e hetimit administrativ si dhe mbi përbërjen e trupit gjykues. Subjekti i rivlerësimit nuk i është përgjigjur këtij njoftimi të kryer në mënyrë të përsëritur dhe të shtrirë në një periudhë të gjatë kohore.
15. Më tej, pasi është kontaktuar me telefon nga sekretaria gjyqësore, znj. Zhilla e ka konfirmuar disponimin dhe saktësinë e adresës së *email*-it, në të cilin ajo ishte kontaktuar edhe më herët nga Komisioni. Gjithashtu, subjekti ka bërë me dije se ajo ka rreth 3 vjet që është larguar nga detyra dhe nuk është më subjekt rivlerësimi e as nuk është më e interesuar për procesin e rivlerësimit.

16. Në vijim, gjendur sërish në mungesë të një përgjigjeje me *e-mail* nga subjekti, Komisioni ka nisur në banesën e subjektit të rivlerësimit shkresën e datës 31.5.2023, me qëllim arritjen e komunikimit lidhur me këtë proces, duke i ritheksuar nevojën për bashkëpunim nga ana e saj.
17. Në përgjigje të sa më sipër, duke pretenduar se nuk është më subjekt rivlerësimi, me shkresën e datës 12.6.2023 znj. Zhilla ka përcjellë pranë Komisionit një kërkesë për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit dhe kësisoj mosvijimin e proceduarave të hetimit administrativ ndaj saj.
18. Më tej, pasi edhe disa *email*-e të mëpasshme drejtuar subjektit kanë mbetur pa përgjigje, në këto kushte, Komisioni iu drejtua sërish subjektit me shkresën e datës 22.6.2023, duke i kërkuar që të shprehet në lidhje me pasojat e mundshme të ndërprerjes së procesit të rivlerësimit, si dhe në raport me nevojën dhe vullnetin e saj për të marrë pjesë në një seancë publike mbi procesin e rivlerësimit ndaj saj.
19. Nëpërmjet përgjigjes shkresore të datës 4.7.2023, znj. Zhilla, duke përmbledhur dinamikën e lirimimit të saj nga detyra, të datës 25.11.2019, ka pretenduar (sërish) që të mos jetë subjekt rivlerësimi, duke konfirmuar kërkesën për ndërprerje/pushim të procesit të rivlerësimit ndaj saj. Gjithashtu, në këtë shkresë/përgjigje (datë 4.7.2023), duke iu referuar sa i ishte kërkuar nga Komisioni, znj. Zhilla është shprehur se ajo nuk ishte e interesuar për të marrë pjesë në një seancë publike lidhur me procesin e saj të rivlerësimit.

## **II. ARSYET PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT**

20. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
21. Trupi gjykues konstaton se znj. Sofia Zhilla në momentin e hyrjes në fuqi të dispozitave të lartpërmendura ka qenë me funksion inspektore pranë ish-KLD-së, duke qenë kështu në rrethin e subjekteve të rivlerësimit që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit *ex officio*.
22. Trupi gjykues, pasi u njoh me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.10.2019 – me të cilin KLGJ-ja ka deklaruar mospasjen e statusit “Magjistrat”, si dhe me urdhrin nr. \*\*\*, datë 25.11.2019 dhe me të cilin ky institucion e ka liruar nga detyra e inspektore znj. Zhilla – ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit Sofia Zhilla nuk e ka statusin e magjistratit dhe as nuk gjendet më në pozicionin e inspektore. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se në këtë kontekst të veçantë dhe për shkak të efekteve e pasojave të shkaktuara nga aktet e sipërcituara, znj. Zhilla (ndërkohë) ka humbur edhe statusin e subjektit të rivlerësimit, siç argumentohet në vijim.

### **a) Lidhur me statusin e znj. Sofia Zhilla në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese dhe të ligjit nr. 84/2016**

23. Sikurse është përshkruar edhe më sipër, në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese dhe të ligjit nr. 84/2016, znj. Sofia Zhilla ka qenë duke kryer funksionin e inspektore pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Për rrjedhojë, bazuar në: (i) pikën 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; (ii) ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”; (iii) ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” – asokohe znj. Sofia Zhilla ka plotësuar kushtet

e mbartjes së statusit si subjekt rivlerësimi *ex officio*.

24. Ligji nr. 8811/2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 14<sup>1</sup> parashikonte se inspektorët e KLD-së përzgjidhen ndërmjet gjyqtarëve që përmbushin kushtet për t’u emëruar gjyqtarë në gjykatat e apelit dhe në mungesë të tyre ndërmjet juristëve që kanë shërbyer si gjyqtarë jo më pak se 5 vjet. Gjithashtu, referuar nenit 28<sup>2</sup> të ligjit nr. 9877/2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 15<sup>3</sup> të ligjit nr. 8811/2001, gjyqtarët që shërbenin në KLD në përfundim të periudhës përkatëse ktheheshin në vendin e mëparshëm të punës. Ndërsa për inspektorët që vinin nga jashtë sistemit gjyqësor nuk parashikohej që në përfundim të mandatit të emëroheshin si gjyqtarë, por parashikohej se periudha e ushtrimit të funksionit të inspektorit njihet si periudhë vjetërsie në punë si gjyqtar, për efekt të kërkesave të karrierës profesionale.
25. Gjithashtu, në rregulloren nr. 195/2/a, datë 5.7.2006, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, në nenin 18 parashikohej se: “2. *Kryeinspektori apo inspektori [...] në përfundim të mandatit me kërkesë të tij riemërohet pa konkurs në funksionin e gjyqtarit, në gjykatën e fundit ku ai ka punuar në këtë funksion dhe me pëlqimin e tij, në një gjykatë tjetër të të njëjtit nivel ose të një niveli më të lartë*”.
26. Në kuptim të dispozitave të mësipërme rezulton se inspektorët pranë KLD-së mund të ishin inspektorë që vinin nga sistemi gjyqësor dhe gëzonin statusin e gjyqtarit, si dhe inspektorë që vinin nga jashtë sistemit gjyqësor, që nuk gëzonin statusin e gjyqtarit, por kishin punuar dikur si gjyqtarë.
27. Në rastin konkret rezulton se znj. Zhilla ka ushtruar detyrën e gjyqtares deri në datën 20.3.1999, kur është shkarkuar nga KLD-ja. Nuk rezulton që znj. Zhilla këtë vendim të KLD-së ta ketë kundërshtuar në gjykatë, por ka vijuar ushtrimin e profesionit të avokatit pranë Dhomës së Avokatisë Tiranë e, më pas, është emëruar specialiste finance në sektorin e prokurimeve publike pranë Presidencës. Në datën 18.3.2013 është emëruar në detyrën e inspektore, me mandat 5-vjeçar pranë këtij institucioni, mandat i cili është zgjatur deri në krijimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë<sup>4</sup>.
28. Nisur nga parashikimi kushtetues i pikës 3 të nenit 179/b<sup>5</sup>, i cili ka parashikuar mes subjekteve të rivlerësimit edhe inspektorët pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe nga jurisprudenca e Kolegjit të Posaçëm të Apelit<sup>6</sup>, që ka arsyetuar se subjektet e rivlerësimit që i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio* janë të gjitha ato që në momentin e hyrjes në fuqi të

<sup>1</sup> Neni 14 parashikon: “1. Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë përbëhet nga Kryeinspektori dhe inspektorët... 3. Kandidaturat e inspektorëve përzgjidhen, pas shpalljes publike, ndërmjet gjyqtarëve që përmbushin kushtet për t’u emëruar gjyqtarë në gjykatat e apelit dhe, në mungesë të tyre, ndërmjet juristëve që kanë shërbyer si gjyqtarë jo më pak se 5 vjet”.

<sup>2</sup> Neni 28 parashikon: “Gjyqtarët, me kërkesën e institucioneve e pëlqimin e tyre, si dhe me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mund të shërbejnë për një afat deri në 3 vjet në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, të administratës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndihmës ligjor ose këshilltar i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë dhe të gjykatës së apelit, prokuror, pedagog ose drejtor në Shkollën e Magjistraturës. Në përfundim të këtij afati, gjyqtarët kthehen në vendin e mëparshëm të punës. 2. Trajtimi financiar i gjyqtarëve gjatë kësaj periudhe bëhet nga institucionet përkatëse, duke i dhënë pagën më të lartë ndërmjet dy pagave. 3. Periudha e shërbimit njihet si periudhë vjetërsie në profesion si gjyqtar, për efekt të pagës dhe të karrierës profesionale”.

<sup>3</sup> Neni 15 parashikon: “Inspektorët emërohen në këtë detyrë për një afat 5-vjeçar, me të drejtë riemërimi. 2. Periudha e ushtrimit të funksionit të inspektorit njihet si periudhë vjetërsie në punë si gjyqtar për efekt të kërkesave të karrierës profesionale. Gjyqtarët, që shërbejnë si inspektorë në Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me kërkesë të tyre, riemërohen gjyqtarë pa konkurs”.

<sup>4</sup> Vendimi nr. \*\*\*, datë 18.2.2020, i Gjykatës Administrative të Apelit.

<sup>5</sup> Neni 179/b parashikon: “3. Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*”.

<sup>6</sup> Vendimet nr. 16, datë 19.4.2023 (JR) (pg. 16.5) dhe nr. 46, datë 1.12.2022 (JR) (pg. 16.1).

ndryshimeve kushtetuese, me anë të ligjit nr. 76/2016, janë duke ushtruar funksionet listuar në nenin 197/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, Komisioni vlerëson se në kushtet kur znj. Zhilla është emëruar si inspektore në KLD nga jashtë sistemit gjyqësor (pasi ajo nuk gëzonte statusin e gjyqtarit, sipas vendimit të KLGJ-së<sup>7</sup>), por në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, ajo gëzonte statusin e inspektorit jomagjistrat pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, pozicion ky që e kualifikonte/përfshinte atë mes subjekteve që i nënshtroheshin procesit të rivlerësimit *ex officio*.

**b) Lidhur me dinamikën evoluese të rrethanave faktiko-ligjore dhe me vlerësimin nëse znj. Sofia Zhilla mbart edhe aktualisht statusin e subjektit të rivlerësimit *ex officio***

29. Nisur nga sa është përshkruar më sipër dhe nga fakti që znj. Zhilla në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese kishte statusin e inspektorit jomagjistrat dhe bazuar në nenin 165<sup>8</sup> të ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit ajo mund të vazhdonte të qëndronte në këtë detyrë, përveçse kur marrëdhënia e punës përfundon për arsye ligjore, vlen të çmohen në dinamikën e tyre kohore rrethanat faktiko-ligjore të çështjes në analizë.
30. Vërehet se dispozita e lartpërmendur parashikonte se inspektori i KLD-së duhej t'i nënshtrohej testimit në Shkollën e Magjistraturës dhe nëse arrin të paktën 60% të pikëve të testit të aftësive profesionale përfitonte të drejtën që të ndiqte programin teorik njëvjeçar të Shkollës së Magjistraturës. Gjithashtu, në pikën 9 të kësaj dispozite parashikohej se nëse inspektori në detyrë kalon me sukses procesin e rivlerësimit, por nuk ndjek fushën e karrierës së magjistratit, ka të drejtë për t'u caktuar në një pozicion si nëpunës civil në sistemin e prokurorisë ose nëpunës civil gjyqësor në sistemin gjyqësor.
31. Në rastin konkret rezulton se znj. Zhilla nuk i është nënshtrohet testit të aftësive profesionale në Shkollën e Magjistraturës dhe me vendimin e datës 2.10.2019 ka vendosur deklarin e mospasjes së statusit "Magjistrat" dhe duke ndërprerë marrëdhënien e punës me të.
32. Në këto rrethana, nisur nga vendimi nr. \*\*\*, datë 22.10.2019, me të cilin KLGJ-ja ka deklaruar mospasjen e statusit "Magjistrat", si dhe nga efektet e urdhrin të lirimit nga detyra të inspektore Sofia Zhilla, nr. \*\*\*, datë 25.11.2019<sup>9</sup>, Komisioni vlerëson se kombinimi i këtyre dy faktorëve [(i) mospasja e statusit të magjistratit dhe (ii) ndërprerja e marrëdhënies së punës dhe humbja e pozicionit të inspektore] passjell mungesën e vijueshmërisë së mbartjes së statusit të subjektit që duhet të vijojë t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit *ex officio*. Kjo pasi, për sa kohë cilësimi i znj. Zhilla si subjekt rivlerësimi *ex officio* ishte bërë pikërisht duke u bazuar mbi pozicionin e saj si inspektore, pra duke e lidhur këtë cilësim me këtë funksion (në mungesë të statusit të magjistratit), humbja e këtij pozicioni si inspektore

<sup>7</sup> Sipas vendimit nr. \*\*\*, të këtij institucioni, datë 22.10.2019.

<sup>8</sup> Neni 165 parashikon: "2. Subjektet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, vazhdojnë të qëndrojnë përkohësisht në detyrë, në përputhje me parashikimet ligjore, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç kur marrëdhënia e punës përfundon për arsye ligjore ose si rezultat i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"... 4. Subjektet e parashikuara në pikat 1 dhe 3 të këtij neni, të cilët kanë arritur të paktën 60% të pikëve të testit të aftësive profesionale në Shkollën e Magjistraturës, sipas parashikimeve të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve", kanë të drejtë: a) të ndjekin programin teorik njëvjeçar të Shkollës së Magjistraturës. [...] 9. Nëse ndihmësi ligjor, inspektori dhe këshilltari i gjyqtarit në detyrë kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit, por nuk ndjekin fushën e karrierës së magjistratit, kanë të drejtë për t'u caktuar në një pozicion si nëpunës civil në sistemin e prokurorisë ose nëpunës civil gjyqësor në sistemin gjyqësor".

<sup>9</sup> Ky urdher lirim është akimuar nga znj. Zhilla në Gjykatën Administrative, e cila e ka pranuar kërkesën në shkallë të parë. Më tej, pasi vendimi i shkallës së parë është ankimuar nga KLGJ-ja, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. \*\*\*, datë 6.2.2024, ka pranuar ankimin e KLGJ-së, duke e prishur vendimin e shkallës së parë dhe kështu duke rrezuar kërkesëpadinë e znj. Zilla dhe lënë në fuqi urdhrin e lirimit nga detyra të inspektore Sofia Zhilla, nr. \*\*\*, datë 25.11.2019. Ndaj këtij vendimi znj. Zhilla ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

bën që të humbasë edhe cilësimi si subjekt rivlerësimi.

33. Nisur nga sa më lart, Komisioni – pavarësisht formës së largimit nga detyra duke u shkarkuar/liruar nga funksioni, në kuptimin formal dhe ligjor, por duke u fokusuar tek pasojat ligjore, pra në faktin që ajo aktualisht nuk është më e punësuar pranë këtij organi (KLGJ-së) – duke mbajtur në vëmendje disa elemente të kuadrit faktiko-juridik të kësaj çështjeje dhe konkretisht që znj. Zhilla: (i) nuk e ka statusin e magjistratit; (ii) nuk e ka më funksionin e inspektores dhe nuk është larguar nga ky pozicion me dorëheqje; (iii) nuk mbulon aktualisht asnjë pozicion në sistemin e drejtësisë; dhe (iv) ka paraqitur një kërkesë për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit – çmon se znj. Sofia Zhilla aktualisht nuk mban më statusin e subjektit të rivlerësimit dhe, për pasojë, nisur edhe nga kërkesa e saj, çmohet se procesi i rivlerësimit për këtë subjekt duhet të përfundojë pa një vendim përfundimtar. Kjo pasi vlerësohet se në mungesë të statusit të magjistratit, siç është rasti konkret, në momentin që subjektit të rivlerësimit i ndërpritet detyra funksionale – si element përcaktues që e ka cilësuar atë si një subjekt që duhet t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit *ex officio* – rrjedhimisht humbja e funksionit/detyrës në fjalë e zhvesh atë edhe nga cilësimi si subjekt rivlerësimi, duke mos e legjitimuar vijueshmërinë e mëtejshme të këtij procesi.
34. Komisioni vëren gjithashtu se, në këto kushte, vijimësia hipotetike e procesit të rivlerësimit, i cili në përfundim do të duhej të konkludohej me një vendim përfundimtar duke u shprehur, si zakonisht, me një dispozitiv mbi konfirmimin, pezullimin apo shkarkimin e subjektit nga detyra, në këtë rast nuk mundësohet, pasi subjekti nuk është më në këtë detyrë për shkaqe të tjera. Kësisoj, kjo rrethanë specifike e bën të pamundur vijimin dhe konkludimin e procesit të rivlerësimit të znj. Sofia Zhilla, për sa kohë ka munguar qëllimi i këtij procesi rivlerësimi, duke e bërë kështu të pamundur përfundimin e këtij të fundit.
35. Në rrethanat dhe për shkaqet e lartpërmendura, Komisioni çmon se në rastin konkret gjen aplikim neni 95<sup>10</sup> i Kodit të Procedurave Administrative, i ndryshuar e, për pasojë, procesi i rivlerësimit për znj. Sofia Zhilla duhet të deklarohet i përfunduar, pa një vendim përfundimtar, për shkak se ajo ka humbur statusin e subjektit të rivlerësimit.

### **c) Lidhur me aplikimin e mundshëm të nenit G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës**

36. Në kushtet e mosvijimit të procesit të rivlerësimit, përpos efektit të përfundimit të procesit të rivlerësimit, për shkaqet e mësipërme dhe në funksion të kërkesës së vetë subjektit, të paraqitur në datën 14.6.2023, Komisioni duhet të marrë parasysh dhe të çmojë edhe lidhur me pasojën e mundshme ligjore që mund të sjellë kërkesa për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit – nëse duhet aplikuar edhe ndalimi i parashikuar nga neni G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës (i zbatueshëm në rastet e humbjes së statusit për shkak të dorëheqjes – ndonëse në këtë rast nuk kemi të bëjmë me dorëheqje). Në rast se kërkesa në fjalë do të vlerësohej si një shkak ndërprerjeje e procesit të rivlerësimit (dhe znj. Zhilla do ta kishte ende statusin e subjektit të rivlerësimit), atëherë kjo ndërprerje do të shoqërohej edhe me aplikimin e nenit G, pika 2 e lartpërmendur, ndërkohë që në rastin e përfundimit të procesit pa një vendim përfundimtar nuk ka vend për aplikimin e këtij ndalimi. Në këtë kuadër merr rëndësi raporti i mundshëm shkak-pasojë midis vullnetit (të mundshëm) të subjektit dhe shuarjes së statusit të subjektit të rivlerësimit, sikurse analizohet në vijim.
37. Komisioni, në vijim të sa është përshkruar e argumentuar më sipër, konstaton se mosvijimi

<sup>10</sup> Neni 95 i Kodit të Procedurave Administrative ka parashikuar pamundësinë në objekt apo qëllim, ku sipas kësaj dispozite, *organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.*

në pozicionin e inspektore – si shkak përcaktues për humbjen e cilësimit si subjekt rivlerësimi – ka ardhur jo për vullnetin e znj. Zhilla, e cila nuk ka paraqitur dorëheqje për t’u larguar nga funksioni i saj. Kësisoj, nuk evidentohet asnjë veprim i vullnetshëm i saj me qëllim shmangien nga nënshtrimi në procesin e rivlerësimit *ex officio*. Gjithashtu, edhe kërkesa e znj. Zhilla për “ndërprerjen/pushimin” e procesit të rivlerësimit, që ka përcjellë pranë Komisionit (në përgjigje të ftesës që i ishte bërë për t’u aktivizuar si pjesë/palë e këtij procesi), nuk mund të vlerësohet si një dorëheqje, por si një kërkesë për të evidentuar stadin aktual faktik, që nuk e cilëson më atë si një subjekt rivlerësimi.

38. Komisioni – në mënyrë që të vlerësohej mundësia hipotetike e ndonjë vullneti për shmangien e procesit të rivlerësimit, me qëllim për të vijuar karrierën profesionale brenda sistemit të drejtësisë në ndonjë detyrë tjetër (të ndryshme nga ajo që i jepte statusin e subjektit të rivlerësimit) – ka verifikuar, për aq sa është mundur nga burimet e hapura dhe të aksesueshme, dhe nuk rezultoi që znj. Zhilla të jetë emëruar në ndonjë funksion tjetër pranë ndonjë institucioni të sistemit të drejtësisë, pas largimit të saj nga detyra në vitin 2019.
39. Gjithashtu, Komisioni ka mbajtur në vëmendje edhe qëndrimet në jurisprudencën e Kolegjit<sup>11</sup>, që lidhur me këtë pikë, veç të tjerash, është shprehur se në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, vullneti i subjekteve për të mos iu shmangur procesit të rivlerësimit shprehet vetëm nëpërmjet qëndrimit në detyrë dhe përfundimit të procesit të rivlerësimit dhe se çdo largim i vullnetshëm nga detyra (me dorëheqje) bënte të aplikueshëm pikën 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës – si pasojë ligjore që sjell dorëheqja nga detyra, duke ndërprerë ecurinë e procesit të rivlerësimit deri në përfundim. Kësisoj, humbja e statusit të subjektit të rivlerësimit me vullnetin e tij (pavarësisht motiveve dhe qëllimeve që e shtyjnë atë drejt këtij akti) e bën të pamundur vijimin e këtij procesi rivlerësimi (edhe në kushtet kur subjekti kërkon t’i nënshtrohet atij). Kjo pasi, ndërprerja e procesit dhe vendosja e ndalimit të parashikuar nga neni G i Aneksit të Kushtetutës konsiderohet si alternativë imperative dhe e vetme për t’u zbatuar në rastet e humbjes së statusit të subjektit për shkak të dorëheqjes së paraqitur vullnetarisht dhe specifikisht nga i interesuari.
40. Në këto kushte, deduksioni logjik konsiston në faktin se askujt prej atyre që mund ta kenë humbur statusin e subjektit të rivlerësimit jo për vullnetin e tyre, pra pa dorëheqje, nuk mund t’i aplikohet ndalimi i parashikuar nga neni G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Duke qenë se rasti konkret gjendet në këto kushte, për sa kohë humbja e pozicionit funksional të inspektore ka ardhur për shkak të lirimit nga detyra dhe jo nga dorëheqja, në konkluzion Komisioni çmon se për znj. Sofia Zhilla nuk duhet të aplikohet pika 2 e nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në pikën 2/b të nenin 140 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në shkronjën “ç” të pikës 1 të nenit 64 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar, me shumicë votash,

<sup>11</sup> Vendimet nr. 29 (JR), datë 7.10.2021 - pg. 11-14; nr. 32 (JR), datë 14.10.2021 - pg. 13.9 -13.18 dhe nr. 21, datë 17.6.2022 (JR) - pg. 15.11.



## **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Sofia Zhilla pa një vendim përfundimtar, për shkak se ajo ka humbur statusin e subjektit të rivlerësimit.
2. Ky vendim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 29.5.2024.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Etleda ÇIFTJA**  
**Kryesuese (kundër)**

**Lulzim HAMITAJ**  
**Relator**

**Firdes SHULI**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Jonida Vrana*